Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas-Agencija za Besplatnu Pravnu Pomoć
Agency for Free Legal Aid

Datë: 17.06.2025

Në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-017 [I plotësuar/ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-035 dhe Nr.08/L-063] dhe Rregulloren MD - NR. 05/2023 për Përcaktimin e kritereve për ofrimin e ndihmës juridike falas nga organizatat Jo Qeveritare në partneritet me agjencinë organizative për ndihmë juridike falas, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) publikon këtë:

NJOFTIM

Për OJQ-të lidhur me hyrjen në partneritet me ANJF për Ofrimin e Ndihmës Juridike Falas

Në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-017 [I plotësuar/ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-035 dhe Nr.08/L-063] OJQ-të mund të ofrojnë Ndihmë Juridike Falas vetëm në rastet kur hyjnë në partneritet me Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas (ANFJ). Në përputhje me obligimet ligjore, Ministria e Drejtësisë tanimë ka nxjerrë Rregulloren MD - NR. 05/2023 për Përcaktimin e kritereve për ofrimin e ndihmës juridike falas nga organizatat jo qeveritare në partneritet me ANJF.

Në përputhje me Ligjin për Ndihmë Juridike Falas dhe Rregulloren Nr.05/2023, ANJF fton të gjitha OJQ-të që të hyjnë në partneritet me ANJF në mënyrë që të ofrojnë ndihmë juridike falas.

Për hyrje në partneritet me ANJF, OJQ-ja duhet t'i plotësojë:

Kriteret të përgjithshme:

1.1. të jetë OJQ e regjistruar në Republikën e Kosovës;
1.2. të jetë OJQ me veprimtari të përqendruar në njërën nga këto fusha si:
    1.2.1. ndihmën juridike falas;
    1.2.2. të drejtat e njeriut, dhe
    1.2.3. fushën e drejtësisë.
1.3. të ketë strukturë organizative të përcaktuar me aktet e brendshme të organizatës.

Kriteret e veçanta:

1.1. të parasheh në Statutin e saj se do të ofrojë shërbime të ndihmës juridike falas;
1.2. të ketë në kuadër të saj një anëtar të personelit me provim të dhënë të jurisprudencës;
1.3. të mos jetë në procedurë të falimentimit apo shuarjes;
1.4. që OJQ - ja të mos ketë aktakuzë të konfirmuar;
1.5. të mos ketë obligime të pa paguara tatimore ndaj Administratës Tatimore të Kosovës apo ka marrëveshje për shlyerje të borxheve;
1.6. emri, logoja dhe tiparet tjera identifikuese të OJQ - së të mos kenë ngjashmëri me ato të Agjencisë;
1.7. të posedojë hapësirë në zyrë të përshtatshme sipas vendosjes, hapësirës, pajisjes dhe rregullimit, e cila duhet të ketë hapësirën e përgjithshme së paku 20 m² dhe të përmbajë së paku dhomën e pritjes dhe dhomën e punës.

Përmes këtij njoftimi, ftohet OJQ-të që të paraqesin në ANJF kërkesën për hyrje në partneritet me ANJF për ofrimin e ndihmës juridike falas.

Afati për dorëzimin e kërkesave është nga dt. **17.06.2025** deri më **01.07.2025**.

Kërkesa (Forma 1 e Rregullores Nr.05/2023) për hyrje në partneritet me ANJF për ofrimin e ndihmës juridike falas parashtrohet në ANJF.

Kërkesës për hyrje në partneritet duhet ti bashkëngjiten dokumentet si në vijim:

1. Letërnjoftimi i/e përfaqësuesit/ës ligjor/e;
2. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;
3. Statuti i OJQ-së;
4. Dokumentacioni relevant tatimor;

5. Dëshmia që organizata nuk ka aktakuzë të konfirmuar;
6. Logo e organizatës apo njësisë që do të ofrojë shërbimet e ndihmës juridike falas;
7. Kopjet e të gjitha certifikatave të diplomimit universitar dhe dokumentet e licencës juridike (provimit të jurisprudencës);
8. CV-të e të gjithë personelit që do të ndërveprojë me kërkuesit e ndihmës juridike falas;
9. Organogrami.

Kërkesa për hyrje në partneritet, së bashku me dokumentet relevante, mund të dorëzohet në mënyrë elektronike në e-mail-in **info.anjf@rks-gov.net** apo fizikisht në objektin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, rr. "Zenel Salihu" nr. 30 Prishtinë.

ANFJ do të vendos lidhur me kërkesën për hyrje në partneritet për ofrim të ndihmës juridike falas në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i kërkesës.